



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
V E N D I M

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
KANDIDATIT PËR KRYETAR BASHKIA POGRADEC, z.ILIR XHAKOLI NË ZBATIM TË
LIGJIT NR.138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË
ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 16.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar Bashkia Pogradec, z. Ilir Xhakolli në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, i Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 5, pika 4, gërma a i ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



Nr . 461 i vendimit Data 16.05.2019 e vendimit Ora 17:30 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Pogradec, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VËREN

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" ka depozituar në KQZ Kërkesën për rregjistrimin e Z. Ilir Telha Xhakolli si kandidat për kryetar të bashkisë Pogradec.

Gjithashtu Z. Ilir Telha Xhakolli në përputhje me nenin 5, pika 4, gërma a të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton Z. Ilir Telha Xhakolli nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa b dhe pikës 3, germa c, të vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes dhe zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore, sipas së cilës rezulton se Z. Ilir Telha Xhakolli është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të Kreut V të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit konstaton se dhënat e deklaruara nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit sipas ligjit 138/2015. Gjithashtu KQZ ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, gërma f të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, 6 të nenit 9 të udhëzimit nr.2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve", KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për regjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, të propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE:



Nr . 461 i vendimit Data 16.05.2019 e vendimit Ora 17:30 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Pogradec, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa a, e Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, gërma f, të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VENDOSI:

1. Njoftimin e KZAZ-së nr. 67 për vazhdimin e procedurave për rregjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, të propozuar nga Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr . 461 i vendimit Data 16.05.2019 e vendimit Ora 17:30 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Pogradec, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".